



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.159

23 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1027, datë 8.10.2009	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.2.2009, për çështjen nr.12306/04 “Nuri kundër Shqipërisë”	7093
Vendim i KM nr.1028, datë 8.10.2009	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.2.2009, për çështjen nr.45264/04, “Hamzaraj kundër Shqipërisë”	7093
Vendim i KM nr.1029, datë 8.10.2009	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Hyrja Kavajë-Unazë”	7094
Vendim i KM nr.1030, datë 8.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rubik të qarkut të Lezhës	7096
Vendim i KM nr.1031, datë 8.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës	7097
Vendim i KM nr.1032, datë 8.10.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Përmet të qarkut të Gjirokastrës	7098
Vendim i KM nr.1033, datë 8.10.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave “Për statusin “Dëshmor i Atdheut”, të ndryshuar	7099
Vendim i KM nr.1036, datë 14.10.2009	Për shfuqizimin e vendimit nr.891, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e një sipërfaqeje, pronë shtetërore, në fondin e kompensimit fizik dhe vënien e saj në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”	7100

Vendim i KM nr.1039, datë 14.10.2009	Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, si dhe për përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive	7100
Vendim i KM nr.1040, datë 14.10.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.1269, datë 17.9.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”	7108
Vendim i KM nr.1041, datë 14.10.2009	Për vendosjen e autoritetit kombëtar për certifikimin elektronik në varësi të Ministrit të Shtetit për reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin	7108
Vendim i KM nr.1042, datë 14.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Krutje të qarkut të Fierit	7109
Vendim i KM nr.1043, datë 14.10.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të komunës Golem, të qarkut të Tiranës	7110
Vendim i KM nr.1044, datë 14.10.2009	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Odrie të qarkut të Gjirokastrës..	7111
Vendim i KM nr.1051, datë 23.10.2009	Për disa ndryshime në vendimin nr.802, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programit të përbashkët rajonal të studimit “Master në “Eu Business Law”, në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës”	7112

VENDIM
Nr.1027, datë 8.10.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 3.2.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.12306/04 “NURI KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të paragrafit të parë të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore””, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.2.2009, për çështjen nr.12306/04 “Nuri kundër Shqipërisë”, në shumën 76 500 (shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2.Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 7.10.2009.

3.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4.Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankueses znj.Tefta Nuri, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

5.Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankueses, znj.Tefta Nuri, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6.Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1028, datë 8.10.2009

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 3.2.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.45264/04, “HAMZARAJ KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të konventës europiane për të drejtat e njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore””, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 3.2.2009, për çështjen nr.45264/04 “Hamzaraj kundër Shqipërisë”, në shumën 17 500 (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 7.10.2009.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërën nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankueses, znj.Afërdita Hamzaraj, dhe të konvertohet në lekë, me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

5. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankueses, znj.Afërdita Hamzaraj, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor, të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1029, datë 8.10.2009

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
“HYRJA KAVAJË-UNAZË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Hyrja Kavajë-Unazë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1071.5 (një mijë e shtatëdhjetë e një pikë pesë) m², tokë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 16 072 500 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 277 000 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 16 072 500 (gjashtëmbëdhjetë milionë e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.10.2009 dhe të përfundojë më 15.1.2010.

7. Pronarët, për të cilët, në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, është bërë shënimi “Konfirmim nga ZRPP”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS “HYRJA E KAVAJËS-UNAZË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastr.	Nr.pas	Sipërf. përgjith. m2	LLOJI I PASURISË						Shuma në lekë	Shënime
							TRUALL			ARË				
							m2	çmimi	vl.lekë	m2	çmimi	vl.lekë		
1	Nikolla	Mihal	Hotova	8551	1/179,180	1000	82	15000	1230000				1230000	Konf.ZVRPP
2	Lutfi	Jonuz	Veipi	8551	1/237	1150	180	15000	2700000				2700000	Konf.ZVRPP
3	Meleqe	Ali	Tallushi	8551	1/98	600	56	15000	840000				840000	Konf.ZVRPP
4	Bashkëpronarët		Galicaj	8551	1/274	2931	280	15000	4200000				4200000	Konf.ZVRPP
5	Zyhdi	Rrahman	Teferici	8551	1/230	290	78.5	15000	1177500				1177500	Konf.ZVRPP
6	Hasan	Rrahman	Teferici	8551	1/158	1170	40	15000	600000				600000	Konf.ZVRPP
7	Xhavit	Sulejman	Hyka	8551	1/161	600	68	15000	1020000				1020000	Konf.ZVRPP
8	Lavdërim		Lusha	8551	1/99	1165	67	15000	1005000				1005000	Konf.ZVRPP
9	Pronar i papërcaktuar			8551	1/158		35	15000	525000				525000	Konf.ZVRPP
10	Bashkëpronarët		Qarri	8551	1/166	2000	80	15000	1200000				1200000	Konf.ZVRPP
11	Enver		Tallushi	8551	1/168	1000	37	15000	555000				555000	Konf.ZVRPP
12	Shpresa		Kacbufi	8551	1/162	2000	68	15000	1020000				1020000	Konf.ZVRPP
	Shuma						1071.5		16072500				16072500	

Pasuria 1/274 dhe 1/158 janë konfirmuar nga ZVRPP Kavajë me komentin që këto prona janë në proces gjyqësor.

Pasuria 1/230 konfirmuar nga ZVRPP Kavajë. Bllokuar në favor të Bankës Popullore me kontratën nr.2956/1246/1 datë 25.9.9.2008.

Pasuria 1/99 konfirmuar nga ZVRPP Kavajë. Bllokuar në favor të Bankës Popullore me kontratën nr.5367/1069/1, datë 28.6.2006

VENDIM
Nr.1030, datë 8.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË RUBIK, TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rubik të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Rubik të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr.1465, datë 5.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Rubik, të qarkut të Lezhës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Rubik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Rubik

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1 (Pa ndërtesën private)	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-36	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
37-44	Prona që përdoren për realizimin e programeve të shëndetit publik.	Në pronësi
45-47	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
48	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive në fushën e shërbimeve sociale.	Në pronësi
53-55	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
56,189-199,201-203	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
204-212	Varrezat publike	Në pronësi
213-219,229-233,237-244,246-247,251-255,257,259-278,280-445,447-448,450-491,497-530,532-543,545-548,1272-1322	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

492-496,531,1325	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
1131-1132,1136-1137,1141-1143,1147-1148,1151, 1155,1159-1160,1164-1166, 1170-1172,1175,1178-1180,1184,1185	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
1133-1135,1138-1140,1144-1146,1149-1150,1152-1154, 1156-1158,1161-1163,1167-1169,1173-1174,1176,1177, 1181-1183,1186,1187, 1255-1271	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
1229-1254,1323,1324	Infrastrukturë (rrugë vendore)	Në pronësi

VENDIM
Nr.1031, datë 8.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS DISHNICË TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.529, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Dishnicë të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Dishnicë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
2-11	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
12-14	Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive	Në pronësi
15-18	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
19-32	Shërbime funerale	Në pronësi
33-43	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
87-89,91-93,95-96,98-100,102-103,105-106,108-110,112,114-115,117-119,121-123,125-126,128-129,131-132,134-136	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore).	Në përdorim
90,94,97,101,104,107,111,113,116,120,124,127,130,133,137	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore).	Në pronësi
140-141,147-148,151,153,158,159 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe ujitjes	Në pronësi
179-182	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi

VENDIM**Nr.1032, datë 8.10.2009**

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË PËRMET, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Përmet, të qarkut të Gjirokastrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 71 (shtatëdhjetë e një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 415 (katërqind e pesëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
132-136,139,140,145,146, 148,152,154,155,158-162, 165,166,168-170	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
1,3-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
17-34	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
38-41	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
43	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
54,55	Varrezat publike	Në pronësi
56-79,195-218,351-403,411-415	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike	Në pronësi
176-182	Prona në fushë e furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi
232-239,241-347	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
406-410	Toka bujqësore joproductive	Në pronësi
45-53,348	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi

VENDIM**Nr.1033, datë 8.10.2009****PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.151, DATË 25.4.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR STATUSIN “DËSHMOR I ATDHEUT””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8607, datë 27.4.2000 “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “a” të pikës 1 të vendimit nr.151, datë 25.4.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1.Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni Qendror për dhënien e statusit “Dëshmor i Atdheut” kryesohet nga Ministri i Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin dhe përbëhet nga :...:”.

2.Emërtimi “...Zëvendëskryeministri kryetar...”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1036, datë 14.10.2009

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.891, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KALIMIN E NJË SIPËRFAQEJE, PRONË SHTETËRORE, NË FONDIN E
KOMPENSIMIT FIZIK DHE VËNIEN E SAJ NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË KTHIMIT
DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121 e 124 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Shfuqizimin e vendimit nr.891, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kalimin e një sipërfaqeje, pronë shtetërore, në fondin e kompensimit fizik dhe vënien e saj në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave”.

2.Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, bashkia Tiranë dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1039, datë 14.10.2009

PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E
SIPËRFAQEVE TAKUESE TË KËTYRE PASURIVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 e 32, e pikës 1, shkronja “a” të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale, në qarqet e Tiranës, të Elbasanit, të Korçës dhe të Fierit, si dhe përcaktimin e sipërfaqeve takuese të këtyre pasurive.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen e zënë nga ndërtimet informale, të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 103 173,39 (njëqind e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre presje tridhjetë e nëntë) m², tokë/truall, me vlerë të përgjithshme 1 740 578 115,10 (një miliard e shtatëqind e dyzet milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëmbëdhjetë presje dhjetë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme për shpërblimin të përballohet nga fondi i kompensimit të pronave, parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.

4. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me këtë vendim, të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompensuar, në pronësi të shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E PRONARËVE DHE SIPËRFAQET TAKUESE PËR SHPËRBLIM
SIPAS VLERAVE TË TRUALLIT BAZUAR NË V.K.M. NR.1620, DATË 26.11.2008, V.K.M.
NR.653, DATË 29.9.2007, V.K.M. NR.139, DATË 13.2.2008

Nr. pronarëve	Emeri	Atësia	Mbiemri	Numri i zonës kadastrale	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e parcelës që do të shpërblehet (m ²)	Vlera truallit sipas AKKP-së	Vlera e shpërblimit (lekë)
1	2			3	4	5	6	7
	QARKU I TIRANËS							
1	XHIXHE	MUCA(BP)		2380	80/68	1,999.46	1,865.0	3,728,992.90
2	SHPETIM	KARAI		2380	80/74	3,885.06	1,865.0	7,245,636.90
3	TRASHEGIMTARET E RAMIZ E MEHMET GJUZIT			2380	80/85	2,188.20	1,865.0	4,080,993.00
4	ISLAM LAMI			2380	80/12	225.46	1,865.0	420,482.90
5	GENC DUKA(BP)			2380	80/11	79.96	1,865.0	149,125.40
6	PERIKLI	STAVRO	NIKOLLA	8330	5/503	169.00	26,137.0	4,417,153.00
7	FOTI	STAVRO	NIKOLLA					
8	MARGARITA	STAVRO	RUCO					
9	PANAJOT	VANGJEL	GJERASI					
10	STAVRO	VANGJEL	GJERASI					
11	RAJMOND	VANGJEL	GJERASI					
12	OLLGA	MINA	NIKOLLA					
13	JORGO	VANGJEL	NIKOLLA					
14	KRISTO	VANGJEL	NIKOLLA					
15	THEODHOR	VANGJEL	NIKOLLA					
16	MARIE	VANGJEL	NIKOLLA					
17	VIKTOR	ILIA	NIKOLLA					
18	LIGOR	ILIA	NIKOLLA					
19	LUBICA	ILIA	NIKOLLA					
20	NIKOLLA	VASIL	KOZMA					
21	ALEKSANDRA	DHIMITER	COLLAKU					
22	VASILIKA	DHIMITER	JOANIDHI					
23	KRISTOFOR	DHIMITER	KOCA					
24	MARJETA	DHIMITER	SEJDARI					
25	AFROVITI	VASIL	BOCI	8350	1/33	159.90	39,533.0	6,321,326.70
26	GANI		MEMA					
27	MUHAMET		MEMA					
28	SHABAN		MEMA					
29	RESHAT		MEMA					
30	METIJE		BEJLERI					
31	ISMAIL		XHURA	8130	5/251	278.80	24,754.0	6,901,415.20
32	SULO		SULAJ	3866	315/102	339.20	2,578.0	874,457.60
33	SOKOL		XHIXHABESI	3866	315/200	310.40	2,578.0	800,211.20
34	BUJAR	M	EGRA	3866	306/67	394.80	2,578.0	1,017,794.40
35	PELLUMB		AVDILLARI	3866	315/189	86.00	2,578.0	221,708.00
36	SHYQYRI		SULAJ	3866	305/68	418.20	2,578.0	1,078,119.60
37	LUAN		SULAJ	3866	305/71	419.90	2,578.0	1,082,502.20
38	FLAMUR		SAKOLLARI	3866	306/39	322.20	2,578.0	830,631.60
39	LUMTURI		PUPE	3866	306/40	379.20	2,578.0	977,577.60
40	EDUART		GRONO	3866	306/42	266.30	2,578.0	686,521.40
41	PETRO		POTKA	3866	306/261	271.30	2,578.0	699,411.40
42	KADRI		CATRI	8180	3/283	312.70	22,996.0	7,190,849.20
43	FATMIRE		CATRI					
44	FERIDE		PEPOSHI					
45	HAMIDE		HUQI					

46	ALI	RAMAZAN	KARROCI	8180	3/281	737.50	22,996.0	16,959,550.00					
47	GANI	RAMAZAN	KARROCI										
48	NAIM		NDROQI										
49	LULJETA		DOKO										
50	SUZANA		DOKO										
51	HYSEN	ABDYL	KARROCI										
52	SHEFKI	ABDYL	KARROCI										
53	BASHKIM	ABDYL	KARROCI										
54	DASHAMIR	ISA	DUZA	8160	4/288	197.90	37,718.0	7,464,392.20					
55	ALFRED		BENUSI										
56	MAGDA		IKONOMI	8160	4/400	200.00	37,718.0	7,543,600.00					
57	ALFRED		BENUSI										
58	MAGDA		IKONOMI	8380	5/34	63.40	120,000.0	7,608,000.00					
59	KOMUNITETI MYSLIMAN												
60	IBRAHIM	HYSEN	TURKU										
61	BEDRI	HYSEN	TURKU										
62	SEZAI	HYSEN	TURKU										
63	LIRIJE	HYSEN	TURKU										
64	FATBARDHA	HYSEN	TURKU										
65	BP TURKU			8130	5/218	42.40	24,754.0	1,049,569.60					
66	REXHEP		TAF AJ	8120	1/109	424.36	24,360.0	10,337,409.60					
67	NAIM		TAF AJ										
68	ISMETE		TAF AJ										
69	ENGJELLUSHE		TAF AJ										
70	MAJLINDA		TAF AJ										
71	MEHMET		TAF AJ										
72	MIRELA		TAF AJ										
73	JALLDIZ		TAF AJ										
74	GEZIM		TAF AJ										
75	LUMTURI		PASHOLLI										
76	ESAT		ZELA										
77	SHEFQET		ZELA										
78	SKENDER		ZELA										
79	AFERDITA		ZELA										
80	METJE		ZELA										
81	SULLTAN		ZELA										
82	REXHEP		TAF AJ	8120	1/111	75.79	24,360.0	1,846,244.40					
83	NAIM		TAF AJ										
84	ISMETE		TAF AJ										
85	ENGJELLUSHE		TAF AJ										
86	MAJLINDA		TAF AJ										
87	MEHMET		TAF AJ										
88	MIRELA		TAF AJ										
89	JALLDIZ		TAF AJ										
90	GEZIM		TAF AJ										
91	LUMTURI		PASHOLLI										
92	ESAT		ZELA										
93	SHEFQET		ZELA										
94	SKENDER		ZELA										
95	AFERDITA		ZELA										
96	METJE		ZELA										
97	SULLTAN		ZELA										
98	ERVEHE		GOSTIVARI	8120	1/114	1,264.50	24,360.0	30,803,220.00					
99	HYSNI		FAGU										
100	SHPETIM		FAGU										
101	SUZANA		SHEHU										
102	GAZMAND		FAGU										
103	ERMIRA		KOVACI										
104	ALI		FAGU										
105	ZYRA	KADRI	QOKU	8340	7/213	105.30	26,094.0	2,747,698.20					
106	ISMETE	KADRI	QORDJA										
107	DRITA	KADRI	NALLBANI	8190	3/226	110.50	27,104.0	2,994,992.00					
108	B.P MUMAJESI												
109	ISMAIL		ZHURA						8380	7/217,7/99	99.80	120,000.0	11,976,000.00
